



Progetto co-finanziato
dall'Unione Europea



FONDO ASILO, MIGRAZIONE E INTEGRAZIONE (FAMI) 2014-2020
Obiettivo Nazionale: ON 2 Obiettivo Specifico: 2. Integrazione/Migrazione legale
Piano Regionale Multi-Azione IMPACT CASPER II - PROG 2350

Vaksina COVID-19

Të dhënat e fundit të 27 maj 2021

Pyetjet dhe përgjigjet mbi vaksinimin COVID-19

1. C'farë mekanizmi pune kanë vaksinat kundër COVID-19?

Virusi korona SARS-CoV-2, përgjegjes për patologjinë shoqëruese COVID-19, përdor një proteinë (e quajtur 'Spike') që del nga guaska e saj për të depërtuar në qelizat njerëzore, ku më pas riprodhohet. Vaksinat aktualisht në dispozicion janë zhvilluar për të nxitur një përgjigje imune të aftë të bllokojë proteinën Spike dhe kështu të parandalojë virusin nga infektimi i qelizave. Këto vaksina futin në disa qeliza të trupit të njeriut jo koronavirusin SARS COV-2 por informacionin gjenetik të nevojshëm, për të prodhuar, në një kohe të shkurtër, proteinën Spike.

Prania e kësaj proteine të huaj do të stimulojë sistemin imunitar të reagojë kundër saj duke prodhuar antitrupa të cilët, duke u lidhur me proteinën Spike, do të parandalojnë hyrjen e virusit në qelizat dhe infektimin e tyre. Prania e proteinave të huaja Spike gjithashtu do të aktivizojë limfocitet T, që drejtojnë prodhimin e antitropave dhe vrasin qelizat e infektuara me virus. Disa nga këto limfocite mbijetojnë për disa muaj (limfocidet e kujtesës) dhe lejonë që sistemi imunitar i personit të imunizuar të aktivizojë me shpejtësi një reagim të frikshëm kundër një pushtimi të mundshëm të SARS-CoV-2.

2. A u shkurtua prova për të bërë këto vaksina së shpejti?

Studimet që çuan në zhvillimin e vaksinave COVID-19 nuk kaluan asnjë nga fazat e verifikimit të efikasitetit dhe sigurisë të nevojshme për zhvillimin e një ilaçi, në të vërtetë, në këto studime kanë marrë pjesë një numri shumë i lartë vullnetarësh, dhjetë herë më i lartë se ai i studimeve të ngjashme për zhvillimin e vaksinave të tjera. Zhvillimi dhe miratimi i shpejtë është për shkak të teknologjive të reja, burimeve të mëdha të vena në dispozicion në një kohë të shpejtë dhe nëpërmjet një procesi të ri të vlerësimit nga agjencitë rregullatore, të cilat i vlerësuan rezultatet ashtu siç ishin marrë dhe vetëm kur të gjitha studimet ishin përfunduar dhe jo, siç ishin bërë më parë.

3. Sa zgjat mbrojtja e shkaktuar nga këto vaksina?

Kohëzgjatja e mbrojtjes nuk është përcaktuar ende me siguri, sepse deri tani periudha e vëzhgimi ka qenë domosdoshmerisht për pak muaj, por njohuritë mbi llojet e tjera të koronavirusëve sugjerojnë që ajo të jetë se paku 9-12 muaj.

4. Personat e vaksinuar mund të transmetojnë infeksionin tek njerëzit e tjerë?

Qëllimi kryesor i studimeve ishte vlerësimi i efektivitetit të vaksinave në mbrojtjen nga sëmundja COVID-19. Studimet për të përcaktuar nëse njerëzit e vaksinuar në mënyrë asimptomatike mund të infektojnë njerëz të tjerë janë në vazhdim. Meqenëse është e mundur që, pavarësisht imunitetit mbrojtës, në disa raste virusi mund të vazhdojë i fshehur në mukozën e hundës, njerëzit e vaksinuar dhe ata që janë në kontakt me ta duhet të vazhdojnë të marrin masa mbrojtëse kundër COVID-19.

5. A mbrojnë vaksinat vetëm personin e vaksinuar ose anëtarët e familjes së tyre?

Vaksinat mbrojnë personin e vaksinuar, por sa më shumë të jemi të vaksinuar, aq më shumë, ne mund të zvogëlojmë qarkullimin e virusit dhe për këtë arsye gjithashtu të mbrojmë njerëzit që nuk vaksinohen: vaksinimi mbron ata që vaksinohen, por gjithashtu ndihmon në mbrojtjen e komunitetit në të cilin ata jetojnë.

6. Janë raportuar variante të virusit SARS-CoV-2: a do të jenë vaksinat efektive edhe ndaj këtyre varianteve?

Në basë të një frekuence ky virus pëson mutacione. Përgjigjja imune e shkaktuar nga vakcina të mbron kundër pjesës më të madhe të varianteve. Megjithatë kundër disa prej tyre efektiviteti i mbrojtjes mund të jetë i ulët.

7. Përse nuk është e mundur të zgjidhni vaksinën?

Vaksinimi kundër COVID-19 është një e drejtë e njohur për të gjithë, megjithatë rreziku i infektimit dhe i zhvillimit të sëmundjes në një formë serioze nuk është i njëjtë për të gjithë njerëzit dhe, aktualisht, disponueshmëria e dozave nuk është e njëjtë për të gjitha vaksinat. Prandaj, për të garantuar barazinë maksimale të pranueshmërisë, është e nevojshme të ndiqni Planin Stratejik për vaksinimin kundër COVID-19 (Plani i vaksinimit) i hartuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Traduzione a cura di: CIDAS Cooperativa sociale (Ferrara)